



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.10.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Seancë dëgjimore me koordinatorin antitrafik për rezultatet e deritanishme të antitrafikut.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi, Antoneta Dhima, Luan Duzha, Luan Harusha, Spartak Braho, Elena Xhina, Edmond Rrushi, Artemis Dralo, Ylli Shehu, Alban Zeneli dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Myslim Murrizi, Xhemal Qefalia, Anduel Xhindi, Lefter Maliqi dhe Paulin Sterkaj.

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Mimoza Qyra - Koordinatore në Drejtorinë e Antitrafikut dhe të Migracionit

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Sot kemi planifikuar një seancë dëgjimore me koordinatoren kombëtare antitrafik, që në fakt në këtë detyrë është zëvendësministria e Brendshme, zonja Roven Voda, e cila shoqërohet nga zonja Mimoza Qyra, koordinatore në Drejtorinë e Antitrafikut dhe të Migracionit.

Kjo seancë dëgjimore merr shkas edhe nga detyra juaj e posaçme, si koordinatore kombëtare e antitrafikut, është e natyrshme që komisioni ynë sjell vihet në dijeni të rezultateve të punës së institucionit ku ju bëni pjesë, Ministrisë së Brendshme. Por nga ana tjetër dua të vë në vëmendje të kolegëve se ditën e hënë është zhvilluar mbledhja e Këshillit të Integritetit, në të cilën kanë raportuar Ministri i Brendshëm dhe Prokurori i Përgjithshëm. Raportimi është bërë për faktin se progresraporti i vitit 2019 dhe rezolutat që ka miratuar më parë Kuvendi i kanë lënë detyrë Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme dhe luftën kundër trafikëve. Pra, për të njohur më konkretisht këtë pjesë, do të doja ta zhvillojmë këtë bisedë me zonjën Voda, e cila do të bëjë një paraqitje të të gjithë punës së tyre në lidhje me rezultatet antitrafik. Bëhet fjalë për trafikun e qenieve njerëzore, jo për trafikun e drogës apo të narkotikëve, pasi më shpesh dëgjojmë për këtë lloj trafiku dhe interesi ka qenë në këtë drejtim, por kur flitet për trafiket nënkuptohen të gjitha llojet e tyre. Një nga pikat e rëndësishme që mbulon institucioni i Ministrisë së Brendshme dhe ka për detyrë t'i përgjigjet duke vënë në lëvizje të gjitha instrumentet e tij është pikërisht lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore.

Nga ana e Komisionit për Sigurinë do të kemi një qëndrim për relacionin tuaj nga zonja Gjebrea, e cila më parë ka qenë në këtë detyrë dhe i ka dedikuar një pjesë të kohës si ish- zëvendësministre e Brendshme, por edhe më vonë si kryetare e Aleancës së Grave Deputete për këtë pjesë.

Faleminderit, zonja Voda!

Fjala është për ju.

Rovena Voda - Mirdita!

Faleminderit, zonja kryetare e Komisionit!

Më lejoni ta filloj këtë prezantim me një falënderim për ju, për vëmendjen e veçantë për këtë çështje kaq sensitive!

Unë ndaj të njëjtin mendim me ju, që shpesh kur flasim për trafikë, gjithmonë nënkuptojmë trafiket e lëndëve narkotike, por harrojmë anën tjetër të një veprimtarie penale siç është ajo kriminale, apo trafikimi i qenieve njerëzore.

Për më tepër, zonja kryetare, kjo seancë dëgjimore ka sens apo është aktuale. sepse jemi në muajin tetor, që e quajmë edhe muajin antitrafik.

Ju falënderoj ju dhe komisionin tuaj!

Më lejoni të bëj një prezantim të përgjithshëm për trendin, format e trafikimit, metodat e shfrytëzimit në përgjithësi në Republikën e Shqipërisë dhe sfidat që hasim në punën tonë të përditshme si Zyrë e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik. Shqipëria vazhdon të bëjë përpjekje të vazhdueshme në lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo është pasqyruar edhe në progresraportet e Komisionit Europian, por edhe në TIP report, *Trafficking in Persons Report* të Departamentit Amerikan të Shtetit, ku Shqipëria prej disa vjetësh ndodhet në “Lidhjen 2”, në vendet ku sigurisht jepen disa rekomandime për të përmirësuar punën, por të paktën Shqipëria nuk futet në listën e zezë të vendeve, ku ky fenomen është problem. Unë do të thosha se Shqipëria prej më shumëse 8-9 vjetësh nuk cilësohet ndër ato vende ku ky fenomen përbën një shqetësim të madh. Gjithsesi mbetet sfida, jo vetëm për Shqipërisë që është një vend i vogël, për shkak edhe të pozicionit gjeografik që ka, është një vend kalimi, transiti, por mbetet sfida edhe për vendet e zhvilluara si: Franca, Italia, Gjermania apo Mbretëria e Bashkuar me nismën e fundit të ish- Kryeministres britanike Tereza Mei për **“Call to action”** lidhur me *“modern slaving”*. Pra, do të thosha se kemi të bëjmë me një sfida globale. Për të pasur një veprim të koordinuar ndaj luftës së trafikimit të qenieve njerëzore Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik është ajo që bën koordinimin, është më tepër në rolin e një koordinatori të të gjitha institucioneve.

Ne kemi miratuar vjet në dhjetor të vitit 2018 një plan veprimi 2018-2010 për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Është një plan veprimi, i cili është konsultuar gjerësisht. Ndoshta konsultimi mori pak kohë, por mendoj se kemi arritur në një produkt të mirë, duke u konsultuar me të gjithë anëtarët e mekanizmit kombëtar të referimit, pra me të gjitha institucionet qendrore shqiptare, por edhe me partnerët tanë ndërkombëtarë: me ambasadën britanike, atë amerikane, delegacionin e BE-së, si dhe me ambasada të tjera në Shqipëri.

Veprimet antitrafikim janë fokusuar kryesisht në rivitalizimin dhe forcimin e strukturave kombëtare në identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në nivel qendror, por edhe lokal, kontrollin e trafikimit të brendshëm, kryesisht të fëmijëve dhe

të grave, përmirësimin e standardeve të identifikimit dhe mbrojtës së viktimave, intensifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për parandalimin dhe rritjen e ndërgjegjësisë së publikut dhe të personelit që punon me shërbimet e ndihmës.

Nga të dhënat statistikore, të grumbulluara dhe të përpunuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik trendi i trafikimit vitet e fundit vazhdon të mbetet i njëjtë, nuk ka ndonjë ndryshim, flas për 5-6 vjetët e fundit, ku numri varion nga 95-105 viktima trafikimi apo viktima të mundshme trafikimi. Në vitet 2016 dhe 2018 janë identifikuar 95, 105 në vitin 2017, ndërsa për periudhën 9 - mujore janar-shtator 2019 janë identifikuar 80 viktima trafikimi dhe viktima të mundshme trafikimi.

Disa nga format me të cilat ne përballemi, format më të përhapura të trafikimit janë: shfrytëzimi seksual, që mbetet forma kryesore e trafikimit, si për femrat, ashtu edhe për meshkujt për qëllime të ndryshme të shfrytëzimit, numrin më të madh të referimeve të veprave penale e përbën vepra penale trafikimi i personave të rritur me qëllim shfrytëzimin për prostitucion.

Një metodë tjetër e shfrytëzimit është ajo e lypjes. Shfrytëzimi i fëmijëve për lypje vazhdon të mbetet një nga llojet e shfrytëzimit, një shqetësim me impakt edhe në shoqërinë tonë. Viktimat kryesisht përdoren për lypje brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por edhe jashtë vendit, përgjithësisht në vendet e rajonit, veçanërisht në Kosovë, ku kufirin e kalojnë edhe me lehtësi. Kjo vërehet në kohën e sezonit turistik.

Për sa i përket mënyrës së rekrutimit, kryesisht përzgjidhen vajza të cilat janë me prindër të divorcuar, pa mbështetje apo në vështirësi ekonomike. Kemi të bëjmë me një target grup vulnerabël.

Një mënyrë tjetër është rekrutimi nëpërmjet rrjeteve sociale, një formë e re, e vërejtur vitet e fundit, një trend i ri trafikimi, pra rekrutimi i viktimave nëpërmjet rrjeteve sociale si: *Facebook, Instagram, Snapchat* e të tjera.

Një rast tjetër është ai i ofertave për punë, si balerina nëpër lokale, brenda apo jashtë vendit, kryesisht në shtetet kufi me vendin tonë si: në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Një mënyrë tjetër mbetet edhe ajo nëpërmjet telefonit apo nga persona të tjerë.

Për sa i përket metodologjisë së lëvizjes në kufi në rastet e shfrytëzimit seksual trafikantët për të shmangur dyshimet gjatë kontrollit kufitar dhe identifikimit të tyre në përgjithësi i udhëzojnë viktimat që të kalojnë kufirin pa shoqërimin e tyre, që të mos bien në sy, por në disa raste ata kanë shoqëruar viktimat deri në destinacion. Një tendencë e re e trafikimit e identifikuar në vitin 2017 është trafikimi i 3 shtetasve të mitur me shtetësi

afgane nga flukset migratore. Të mos harrojmë se Shqipëria në vitet 2017-2018 ishte një vend i prekur nga flukset migratore nga vendet e treta: Siria, Afgani e të tjera. Janë raste shumë sporadike, të rralla, por edhe në këto flukse migratore ka raste të identifikimit të viktimave të trafikimit apo viktimave të mundshme të trafikimit. Rasti i 2 shtetasve të mitur të identifikuar me shumë profesionalizëm nga departamenti ynë, nga oficerët tanë të Policisë Kufitare dhe Migracionit ka qenë një rast i tillë.

Tendencë e re për vitin 2018 ishte shfrytëzimi apo dhunimi i viktimave të trafikimit nga persona me shtetësi të huaj, në një rast kemi pasur shtetas maqedonas, në një rast tjetër shtetas arab e të tjera.

Një tendencë tjetër është deklarimi i shfrytëzimit për prostitucion nga ana e bashkëshortëve me qëllim marrjen e azilit. Kjo bën shpeshherë që edhe statistikave në vendet jashtë të ngrenë alarmin, por i bie të jenë statistika të fryra apo false.

Me keqardhje zonja kryetare, mund të them se qytetarët shqiptarë që keqpërdorin të drejtën për të kërkuar azil në vendet e BE-së, sjellin fryrje të statistikave. Shpesh përdorin faktin se shfrytëzohen si viktima të trafikimit për shkak të ushtrimit të prostitucionit, që në shumë raste, rezultojnë pas identifikimeve që bëhen atje dhe komunikimeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit këtu, kjo merr kohë dhe numri në statistikë mbetet: viktimë e mundshme trafikimi, gjë që na dëmton. Më lejoni ta shpreh këtë gjë, sepse është një shqetësim, por nga analiza që kemi bërë, shpeshherë rezultojnë se janë pretendime të pabazuara dhe personi që pretendon se i shfrytëzon, është në fakt bashkëshorti i tyre. Pra, janë bashkëshortët, të fejuarit e të tjerë, por nuk janë aty për qëllime trafikimi.

Në një vizitë të fundit që bëra vjet në Londër dhe nga takimi që zhvillova me përfaqësues të kufirit, të migracionit dhe mekanizmit kombëtar të referimit të tyre, numri i kërkesave të shqiptarëve të ardhur atje ishte i lartë dhe fatkeqësisht ata e shënojnë direkt rastin si një viktimë e mundshme trafikimi. Por çfarë ndodh? Pasi bëhen verifikimet rezultojnë se nuk ndodhemi para rasteve të trafikimit dhe të shfrytëzimit për prostitucion. Sigurisht më pas ata nuk identifikohen si viktima, por ndërkohë kanë ndenjur atje 9 muaj, kanë marrë një leje të përkohshme qëndrimi, për të banuar atje apo qoftë edhe për të gjetur ndonjë punë, por që dëmton anën tjetër të Shqipërisë, anën tjetër të përballjes sonë në fund të ditës me statistikave, qoftë edhe me vendet e BE-së.

Për sa u përket masave ligjore, më lejoni të them se vitet 2018-2019 janë një sfidë edhe për vetë Zyrën e Koordinatorit Kombëtar, por edhe për institucione të përfshira në këtë çështje. Pse? Gjendemi para ligjeve të reja të miratuara në kuadër të reformës në

drejtësi. Ligjet kërkojnë një implementim shumë të mirë, kërkojnë profesionistë, njerëz me njohuri të plota për t'i zbatuar ato.

Zonja kryetare, ju i keni ndjekur edhe nga afër, janë disa ligje, ndryshime të Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale, Kodi i Drejtësisë për të Mitur. I gjithë ky ndryshim i legjislacionit penal apo edhe i ligjeve të tjera specifike, ligji i ri “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” ka sjellë një lloj nevojë imediate. Ajo me të cilën është përballur Zyra e Koordinatorit është trajnimi i strukturave që merren në terren, që punojnë me viktimat. Flas edhe për strukturat që merren me identifikimin dhe parandalimin, siç është Policia e Shtetit. Ata janë gjithmonë vija e parë, por edhe institucionet e tjera që lidhen me integrimin e viktimave: dhënie e asistencës për viktimën, duke futur jo më Shërbimin Social Shtetëror që nuk e ka atë rolin e fortë që ka pasur dikur, por tashmë kryesisht për fëmijët janë Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe njësitë e mbrojtjes së fëmijëve nëpër bashki, që kanë marrë në dorë rolin, flas për fëmijët e mitur që përballen me këtë fenomen. Rastet duhet të referohen direkt në këto njësi kur kemi të bëjmë me fëmijë të mitur.

Ajo që kemi ndeshur ka qenë nevoja për trajnime. Kemi pasur ndihmën e disa misionëve të asistencës në Shqipëri, siç është PAMECA, që është misioni i asistencës së BE-së për agjencitë ligjzbatuese në Shqipëri, por edhe të disa ambasadave, që kanë qenë shumë të angazhuara dhe na kanë ofruar asistencë për trajnim si ambasada amerikane, ajo britanike nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës. Kemi vënë re nevojën që kanë strukturat qoftë të Policisë së Shtetit, qoftë oficerët e Policisë Gjyqësore që janë pranë prokurorive, por edhe vetë prokurorët, sepse ju e dini se janë vepra penale në pjesën më të madhe të tyre, kur nuk kemi të bëjmë me një grup të strukturuar kriminal që do të gjykohen nga prokuroritë e rretheve, ajo eksperiencë që ishte krijuar në Prokurorinë e Krimeve të Renda tashmë në njëfarë mënyre është një eksperiencë, por që vlen të thithet nga prokuroritë e rretheve që do të merren me investigimin e këtyre çështjeve kanë nevojë për trajnim, për trekëndëshin: polici- prokurori - gjykatë (me ndryshimet e fundit). Trajnimet vazhdojnë, ne jemi të angazhuar, vetë Zyra e Koordinatorit ka qenë e angazhuar intensivisht për t'u ofruar të gjitha këtyre institucioneve mbështetjen me trajnime.

Zonja kryetare, vjet, në shtator të vitit 2018 kemi miratuar, kanë ardhur pothuajse në një kohë me planin e ri të veprimit edhe procedurat e reja, standardet e veprimit, PSV-të e reja, në lidhje me mënyrën e identifikimit të viktimave të trafikimit nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Janë procedura standarde të hartuara mirë, jemi munduar të ruajmë standardet me

vendet e BE-së, edhe këtu ka nevojë për një trajnim të vazhdueshëm. Ne po vazhdojmë, por e ndiejmë nevojën dhe do të vazhdojmë edhe këtë vit për të gjithë oficerët e Policisë Kufitare dhe të Migracionit, punonjësit që punojnë në kufi, sepse në raste të shumta kemi vënë re që identifikimi bëhet në pikat e kalimit kufitar në Rinas, në aeroporte, por edhe në pikat e tjera të kalimit detar apo tokësor. Për të rritur veprimtarinë identifikuese të Policisë Kufitare të Migracionit PSV-të e reja, këto procedura ndihmojnë, por kanë nevojë ende për t'i thithur mirë edhe për t'i implementuar ato.

Zonja kryetare, dua t'ju njoftoj edhe për një risi brenda mekanizmit kombëtar të referimit. Jemi munduar ta zgjerojmë pak. Ka shumë organizata joqeveritare, të cilat ofrojnë asistencë në terren për viktimat e trafikimit. Ne kemi një Qendër Kombëtare të Viktimave të Trafikimit në Linzë, por kemi edhe të ashtuquajturat “strehëza” që janë qendra që prej kohësh ofrojnë asistencë, por kemi edhe organizata të tjera që ofrojnë ndihmë direkte në shërbim për viktimat. Kjo është shumë e rëndësishme. Asistenca qoftë psikologjike, qoftë shëndetësore, qoftë për strehim, qoftë edhe për t'i rritur aftësitë e tyre, për të fituar më pas në profesion. Mekanizmi Kombëtar i Referimit është zgjedhur edhe me dy organizata të reja shumë aktive në këtë fushë, që mendoj se janë një vlerë e shtuar.

Një risi tjetër është ngritja për herë të parë, sipas modelit amerikan, e një bordi këshillimor, i cili është një strukturë e posaçme e përbërë nga ish-viktima trafikimi, të riintegruar, pra që sot bëjnë një jetë normale.

U morëm për një kohë të gjatë me termat e referencës. Rregulloren e kemi të përfunduar besoj dhe shumë shpejt do ta kalojmë edhe në Mekanizmin Kombëtar të Referimit. I kemi indentifikuar tre persona, që do të jenë pjesë e bordit këshillimor. Mendojmë se, dakord me prodhimin e politikave, planeve të veprimit, por ndoshta është mirë që gjërat t'i shohim me sytë e ish-viktimave të trafikimit.

Mendoj se kjo është shumë e rëndësishme, pra të arrijmë që realisht të prodhojmë politika efektive dhe të japin atë impakt që duhet te kjo kategori vulnerabël. Unë mendoj se ky bord do të jetë një vlerë e shtuar në punën e MKR-së. Në fakt, kjo është një iniciativë që është përshëndetur nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Për herë të parë, para disa javësh, ne bëmë një mbledhje koordinuese me gjithë donatorët në fushën e antitrafikimit, kjo për të shmangur (meqenëse jemi në fillimet e implementimit të planit të veprimit, sepse ka filluar në 2019-ën), në fakt, mbivendosjen e aktiviteteve, në mënyrë që të fokusohemi aty ku kemi boshllëqe. Kjo tryezë me të gjithë donatorët, në fakt, u vlerësuar shumë. Ne kemi shpërndarë një template për të vendosur

programet, donacionet e tyre dhe ku tentojnë ato dhe zyra e koordinorit kombëtar të jetë një lloj rregullatori në mënyrë që ndihma e partnerëve dhe donatorëve të mos mbivendoset por edhe të fokusohet apo të shpërndahet edhe në shtylla të tjera, realizime aktivitësh, ku ne kemi nevojë.

Edhe në vlerësimin e fundit të TIP Reporter për Ministrinë e Brendshme, jo pse unë vij nga kjo ministri dhe jam koordinator kombëtar aty, por janë shkruar fjalë të mira për përpjekjet e qeverisë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (është e shkruar aty e zeza mbi të bardhë), problematikat apo rekomandimet lidhen në sistemin e drejtësisë.

Unë jam shumë optimiste për vitin që vjen, duke pasur parasysh edhe rezultatet që po jep vetingu, reforma në drejtësi. Është e vërtetë ndoshta që vitet 2017 apo 2018 janë identifikuar si vite me një numër të ulët dënimesh, krahasuar me vitet më parë, pra, dënime finale, dënime të dhëna nga gjykatat për këto lloje veprash ka rezultuar të jenë të ulëta dhe unë mendoj që është presioni i reformës në drejtësi, presioni i vetingut.

Jemi, gjithashtu, të fokusuar shumë te pjesa e ndërgjegjësimit. Jemi munduar të mbajmë kontakte me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, me të gjitha drejtoritë rajonale arsimore në të gjithë republikën e Shqipërisë, sepse mendojmë se sidomos gjimnazistët janë targetgrupet më vulnerabël, por mos të harrojmë se është një çështje që lidhet me mentalitetin. Pra, është mirë kur komunikojmë me këtë grupmoshë për t'i njohur me rreziqet e këtij fenomeni, por edhe për t'i ndërgjegjësuar ata, kështu që është bërë një punë shumë e mirë.

Fushata e ndërgjegjësimit bëhet më intensive, në fakt, gjatë këtij muaj. Kemi një marshim ditën e premte. Ju ftojme edhe ju. Po ju ftoj qysh këtu, por do ta përsëris ftesën në konferencën që do të bëjmë me 30 tetor për këtë çështje.

Unë si koordinator antitrafik kam gjetur mbështetje nga projekti GIZ i qeverisë gjermane, që konferenca këtë vit të mbahet në Shqipëri, por të jetë rajonale. Mendoj të jetë rajonale se Shqipëria, pavarësisht gjithë sfidave që ka, është një shembull i mirë për rajonin, goftë me strukturën e koordinorit kombëtar, ku është bërë një punë shumë e mirë (kam Elonën këtu, paraardhësen time), prandaj po them që trasenë e kam gjetur të shtruar.

Shqipëria ka qenë ndër vendet promotore të bashkëpunimit rajonal me vendet kufitare, me Kosovën, Malin e Zi dhe me Maqedoninë e Veriut. Ne jemi munduar, po punojmë dhe shumë shpejt do të firmosim edhe procedura të unifikuara për trajtimin e viktimave të trafikimit. Gjithashtu, po punojmë (megjithëse janë bërë takime, në kohën që ka qenë zonja Gjebrea, me koordinatorin kombëtar të Greqisë për të mundur që këto procedura

të përbashkëta t'i kemi edhe me kolegët tanë grekë, edhe pse janë një vend i BE-së, sepse lufta ndaj trafikimit nuk duhet të shihet me ndasi, pasi jemi vende kufitare dha ndajmë të njëjtat shqetësime.

Ne kemi një draft gati dhe shpresojmë që deri në fund të vitit të mund ta firmosim edhe me kolegun tonë në Greqi. Disa projekte kanë qenë të mbështetura edhe nga ambasada amerikane

Pra, Shqipëria duke qenë promotore e bashkëpunimit rajonal, unë mendoj se Shqipërisë i bën nder që kjo konferencë të mbahej në Tiranë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonaj Voda!

Më duhet të them se trafiku i qenieve njerëzore është pjesë e krimit të organizuar dhe lufta ndaj krimit të organizuar nënkupton edhe luftën ndaj këtij lloj trafiku, por natyrisht fokusi i punës së Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe gjykatës, agjencive të tjera ligjzbatuese ndryshon në varësi të kontekstit shoqëror të gjërave. Disa vjet më parë lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore ka pasur më shumë theks, ndërkohë theksi është vënë te lufta kundër trafikut të drogës dhe kjo është edhe arsyeja pse konstatimi im i parë është që flitet më shumë për rezultatet e kësaj lufte dhe deputetët vetë ndihem më të informuar në këtë pjesë se sa në një temë tjetër siç është kjo e trafikut të qenieve njerëzore dhe e trafikut të fëmijëve, meqenëse janë dy dispozita të ndara (njëra përfshin trafikimin e të rriturve dhe të femrave kurse trafikimi i fëmijëve mbahet si një dispozitë tjetër në Kodin Penal), por është e rëndësishme qoftë lufta, qoftë njohja, sepse trafikimi nuk është më ai që kemi njohur dikur apo ai që kemi luftuar dikur. Nëse dikur vajzat e mitura rrëmbeheshin për t'u trafikuar kryesisht për qëllime prostitucioni, sikundër edhe ju e thatë në fjalën tuaj, që kjo formë vazhdon të ekzistojë, sot prirja është që kjo të duket më moderne në formë, pra njerëzit nuk rrëmbehen (mund të kenë një lloj konsensusi midis tyre), por jo gjithmonë konsensusi përjashton ekzistencën e veprës penale, sepse në rastin e personave të mitur natyrisht që kjo nuk ka asnjë lloj vlere dhe, nga ana tjetër, kalimet e tyre nëpër pikat e kalimit kufitar. Në fakt, është menduar se trafikimi është momenti kur kalon kufirin, por ka edhe trafikim brenda vendit, se nuk është trafikimi vetëm jashtë vendit. Kjo ndodh në mënyrë të ligjshme. Janë njerëz të pajisur me pasaporta të rregullta ose kanë një vizë, në vendet ku kjo kërkohet, dhe duket sikur kjo nuk ndodh, por, sikundër edhe shifrat që relatoi zëvendësministrja e tregojnë qartë se kjo gjë ndodh.

Neve si Kuvend i Shqipërisë, por edhe si shoqëri na duhet të njohim ecurinë konkrete të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Ju thatë që 5-6 vjetët e fundit shifrat janë po ato. Në fakt, te shifrat ka edhe një diskutim tjetër, sepse shifrat që raporton policia nuk përputhem me shifrat që raporton prokuroria apo edhe gjykata në fund. E kuptoj që i gjithë procesi nuk është thjeshtë një çështje magazinimi, që çfarë fut njëri do dalë deri në fund. Nuk është kështu, megjithatë diferencat duhen analizuar për të kuptuar pse vijnë këto diferenca në raportime.

Nga ana tjetër, na intereson të kuptojmë se çfarë ka ndryshuar nga pikëpamja praktike në luftën që institucionet bëjnë kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Pra, ka plane veprimi, ka procedura standarde dhe ne na intereson të dimë më konkretisht se çfarë parashikojnë këto procedura, çfarë ka ndryshuar në ato procedura, çfarë masash të shtuara janë marrë qoftë brenda vendit, qoftë nëpër pikat e kalimit kufitar për të reduktuar sa të jetë e mundur trafikimin .

Ju folët gjatë për trajnimin dhe unë jam shumë dakord që trajnimi është një pikë e rëndësishme, se, nëse njerëzit nuk janë të njohur me formën e krimit, me mënyrën si ai zhvillohet nga ana objektive dhe si ndodh, patjetër që e kanë të vështirë edhe ta kuptojnë, por është e rëndësishme edhe gjithë pjesa tjetër.

Ajo që do të doja të dëgjoja, por besoj se do të kemi rast edhe nga përgjigjet e pyetjeve të kolegëve, edhe me qëndrimin e zonjës Gjebrea, besoj se do të ishte më mirë ta kishim në fund, në mënyrë që të ndihmonim më mirë njëri-tjetrin se ku mund të fokusoheshim dhe si mund të ecnim më mirë.

Mua nga ju më intereson edhe një informacion tjetër. A ka një kostifikim të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore? Pra, sa fonde harxhon shteti çdo vit për investimin e strukturave në këtë luftë, për trajnimin e struktura etj., etj., përfshi këtu edhe fondet që marrin OJF-të për të kuptuar se rezultatet që ne kemi në këtë luftë shkojnë në vijë të drejtë edhe me buxhetet?

Gjykoj se ne mund ta hapim debatin. Zonja Voda do të na përgjigjet.

Është hera e parë, në fakt, që raporton për këtë gjë, pavarësisht se me Komisionin e Sigurisë ka pasur rast të jetë në një mbledhje më të gjerë se sa rajonale, të cilën ne e bëmë enkas për trafikimin, ku ajo ka pasur një raport të hollësishëm. Unë mendoj që ne si komision duhet ta bëjmë këtë në mënyrë periodike për faktin e thjeshtë që tanimë kemi një njohje shumë të mirë të strukturave të drejtorive të policive nëpër qarqe, kështu që duke i njohur

këto informacione jemi shumë më të orientuar në atë gjykojmë së bashku se duhet ta orientojmë punën tonë.

Urdhëroni, zoti Harusha!

Luan Harusha - Faleminderit!

Në bazë të një informacioni që kam nga një gazetar i Mediaset në Itali, pas një investigimi në kampet e refugjatëve në Siri, rezulton se atje ka qindra shqiptarë, shumica janë gra dhe fëmijë.

A keni ndonjë informacion ju? Ata kanë kërkuar ndihmë nga të gjitha institucionet, por janë shumë të keqtrajtuar.

E dyta, gjatë gjithë kësaj kohe që ju keni punuar këtu, sa raste jashtë Shqipërisë janë identifikuar për trafike dhe sa raste trajtohen në Shqipëri?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Harusha!

Urdhëroni, zonja Voda!

Rovena Voda – Në fakt, ne jemi mësuar që çështjen e atyre qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, që kanë shkuar në kampet e Sirisë, të mos e shohim si çështje të trafikut, por si një çështje që lidhet me ekstremizmin e dhunshëm, me terrorizmin. Është një departament special (më lejoni ta sqaroj si zëvendësministre e brendshme, jo si koordinatorë kombëtarë antitrafik) dhe janë struktura të posaçme, agjenci ligjzbatuese këtu te ne, duke filluar që nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, që është Drejtoria e Antiterrorit, si dhe SHISH-i të cilët kanë fokus të përqendruar në këtë fenomen që përmendët ju.

Pse nuk është konsideruar si trafik, se, në fakt, janë familjarë dhe shumica kanë ikur me dëshirë dhe gjithmonë shihet në këtë prizëm?

Unë nuk di të të them numrin, sepse nuk e mbuloj këtë pjesë, por di të të them se Shqipëria, krahasuar me vende të tjera të Ballkanit Perëndimor nuk është ndër vendet që është në listën e zezë për luftëtarët apo luftëtarët e huaj që janë në kampet e Sirisë.

Nuk mund të jap një përgjigje të saktë, sepse nuk e kam informacionin e saktë për këtë.

Për sa i përket trafikimit apo operacioneve policore, më lejoni të them që për periudhën janar – shtator 2019 janë dy operacione për veprat penale, trafikim personash, shfrytëzim prostitucioni, operacioni policor transit. Në fakt, janë dy operacione të fundit ku janë arrestuar tre persona, një i shpallur në kërkim, dhe operacioni policor “Dojçland”, ku është arrestuar një person dhe dy janë shpallur në kërkim.

Tendenca ka qenë për trafikim ndërkombëtar. Një rast i fundit ka qenë operacioni i Rinasit pak kohë më parë, i identifikimit për shfrytëzim prostitucioni jashtë, ku u identifikuar një femër, meritë kjo edhe e profesionalizimit të oficerëve tanë të kufirit, të emigracionit, që nëpërmjet skringing që i bënë personit, pra një interviste të detajuar në kontrollin e vijës së dytë, kur ajo vajza u mor në pyetje. Pra, u zbulua se aty kishte një rrjet trafikimi, dhe ajo shkonte e trafikuar, për të ushtruar prostitucion në Francë. Ky është një rast i fundit, i ndodhur në Rinas.

Këto janë rastet kryesore. Kryesisht, janë raste të trafikimit për jashtë vendit, jashtë kufijve të territorit të Republikës së Shqipërisë. Unë kam një statistikë të operacione policore, në total. Në fakt, zyra e koordinatorit më ka rreshtuar këtu edhe operacionet që lidhen me dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit. Janë pesëmbëdhjetë operacione të tilla policore vetëm për periudhën janar-shtator 2019, sepse në shumë prej rasteve, kur ka femra, të rinj apo të mitur, për dhënie ndihme të kalimit të paligjshëm të kufirit, shpeshherë këto grupe vulnerabël i konsiderojmë si viktima të mundshme trafikimi. Vetëm pas një *screening*, pas një procesi të hollësishëm intervistimi, ne bindemi që në këtë rast të dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm kufiri, kemi të bëjmë apo nuk kemi të bëjmë me viktima trafikimi.

Këto kisha për të thënë. Kjo është përgjigja ime.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Voda!

Zoti Harusha.

Luan Harusha – Thatë se ata familjarët kanë shkuar me dëshirë, kështu që këtë e quajmë kalim me dëshirë nga territori i Shqipërisë. Por një fëmijë tre-katër vjeç, pesë vjeç a gjashtë vjeç nuk ka pasur si të shkonte me dëshirë për të mbetur nëpër kampet e Sirisë. Ata kërkojnë ndihmë nga të gjitha institucionet, por nuk marrin asnjë përgjigje që prej disa muajsh. Ky është informacion i dy javëve të fundit.

Ermonela Felaj – Luan, a mund ta mbyll unë këtë përgjigje? Në fakt, interesi ynë ka qenë jo thjesht për Rovenën, si koordinatorë kombëtare antitrafik. Pak më përpara, para se të fillonim këtë sesion të ri parlamentar, u përpoqëm por nuk arritëm të rakordonim, kjo edhe për shkak të fushatës zgjedhore e të tjera me radhë, edhe me koordinatorin kombëtar kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Është një detyrë e ndarë. Domethënë, ndiqet dhe trajtohet ndryshe çështja e të gjithë atyre që kanë shkuar për të luftuar, por kanë marrë edhe familjet me vete, duke mbetur në Siri, kryesisht në këtë rajon. Çështje tjetër është kjo që po trajtojmë në përgjithësi. Kështu që, ne do t'i kemi të dyja informacionet. Pra, e nisëm me Rovenën dhe do ta vazhdojmë me

koordinatorin tjetër kombëtar, që të vijë të na raportojë në lidhje me këtë pjesë. Rëndom raportohet e Shqipëria nuk ka probleme të tilla, dhe kështu duket, por gjithsesi nuk i kemi probleme të theksuara, ndërsa Kosova ka probleme më të shtuara se ne, gjë që mbase përbën keqkuptimin sikur ka shqiptarë, sepse shqip flasin të dyja palët. Megjithatë, për të qenë më konkretë, ne do të kemi koordinatorin, që të mund të kuptojmë se çfarë ndodh realisht.

Faleminderit!

Fjalën ia jap fjalën zonjës Dhima.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose po e bëjmë maxhorancë-opozitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E drejtë. Ndjesë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por më parapriu gjinia, përparësia gjinore.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit për prezantimin, zonja zëvendësministre!

Unë kam disa pyetje. Nga ana e Ministrisë së Brendshme është miratuar plani i veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, për periudhën 2018-20120. Aktualisht, jemi në përfundim të vitit të dytë të zbatimit të këtij plani veprimi.

Pyetja ime është: sa janë realizuar detyrimet e këtij plani veprimi nga ana juaj?

Pyetja e dytë: si e vlerësoni ju, si koordinatorë kombëtarë, bashkëpunimin me institucionet brenda vendit, me gjykatën, prokurorinë, si dhe me institucionet ndërkombëtare për zgjidhjen e problematikave, për të cilat ju jeni koordinatorë kombëtarë?

Pyetja e tretë: sa është numri i personave që janë duke u trajtuar në qendrën kombëtare që ndodhet në Tiranë, por njëkohësisht edhe në strehëzat e qendrat e tjera që ndodhen nëpër rrethe si Vlora, ku unë di se është një qendër kundër trafikimit të qenieve njerëzore? Sa është numri i të trajtuarve në këto qendra?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se pyetjet e zonjës Dhima ishin edhe më konkrete, sepse kërkojnë raportim në shifra.

Rovena Voda – Po e filloj nga pyetja e dytë, për të dalë tek e para.

Numri i viktimave të trafikimit, që për momentin gjendet në qendrën ndërkombëtare dhe në *shelter*-ët tanë, është tetëdhjetë për këtë periudhë. Katër prej tyre janë viktima të

trafikimit, të identifikuara si viktima të trafikimit, 76 si viktima të mundshme trafikimi. Prej tyre, femra janë pesëdhjetë e nëntë. Pra, vërejmë se më shumë se pesëdhjetë për qind janë gra, femra. Meshkuj janë njëzet e një. Të mitur janë pesëdhjetë e pesë. të rritur janë njëzet e pesë. Kemi bërë ndarjen në të rritur e të mitur. Pra, pesëdhjetë e pesë janë të mitur. Do të thosha se gjithsesi është shqetësuese. Njëzet e pesë janë të rritur. Shqiptarë janë shtatëdhjetë e gjashtë. Katër viktima janë të huaj. Pra, kemi edhe të huaj.

Lloji i shfrytëzimit për këtë shifër, në tetëdhjetë raste janë për shfrytëzim seksual, njëzet për lypësi, tre raste për vepra të ulëta kriminale, tre raste për situatë rruge, pra fëmijë në situatë rruge. Kjo është ndarja, sipas raportimeve që kemi deri më tani.

Për sa i përket planit të veprimit, faleminderit për pyetjen. Pyetja ishte shumë konkrete, ndaj përgjigja që do të jap do të jetë disi shtruese, plani i veprimit është vërtet për periudhën 2018-2020, por ai është miratuar në fund të vitit 2018, me vendim qeverie. Pra, ky plan veprimi ka hyrë në fuqi në janarin e vitit 2019, kohë kur kemi filluar zbatimin e tij.

Më lejoni që, sipas shtyllave, t'ju parashtroj masat që kemi marrë, pra çfarë kemi bërë ne deri më tani.

Drejtoria e Antitrafikut dhe Emigracionit, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë dhe normojnë veprimtarinë e saj, është fokusuar në drejtim të katër shtyllave. Plan i veprimit bazohet në katër shtylla kryesore, të miratuara me vendim qeverie, për të qenë e saktë, më 26 dhjetor 2012, duke koordinuar dhe ndërmarrë hapa të rëndësishëm.

Shtylla e parë që kemi vendosur në planin e veprimit, është shtylla e ndjekjes penale, që ne mendojmë se është shumë e rëndësishme. Aktivitetet e kësaj shtylle udhëzojnë të gjitha strukturat për zbatimin me përpikëri, në radhë të parë të legjislacionit në fuqi, sepse ju thashë që janë këto ndryshimet e reja të legjislacionit. Masat synojnë të udhëzojnë autoritetet përgjegjëse, që të plotësojnë dhe përmirësojnë legjislacionin, të vënë në lëvizje dhe të shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat e mundshëm, të trajnojnë strukturat përkatëse, për të bërë të mundur ndalimin e të gjitha mënyrave të trafikimit, duke dënuar çdo lloj forme të shfrytëzimit të personave.

Në masat e realizuara në këtë shtyllë, gjëja e parë që kemi bërë lidhet me legjislacionin. Për mendimin tim, edhe si juriste, kuadri ligjor përbën bazën dhe është pjesa më e rëndësishme. Me qëllim përmirësimit dhe plotësimit të legjislacionit penal në fushën që rregullon çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, zyra e koordinorit ka propozuar, por unë jam vënë në dijeni se nuk kanë kaluar, dhe këtu, zonja kryetare, kam mundësinë të kërkoj mbështetjen dhe ndihmën tuaj... Pra, janë propozuar ndryshime në Kodin Penal,

saktësisht të nenit 52/a, 110/a, 128/b, si dhe 114, të cilat konsistojnë në përfshirjen e nenit 100/a dhe 128/b në një nen të vetëm për veprën penale të trafikimit të personave dhe trafikimit të fëmijëve, që të jetë rrethanë rënduese, duke aplikuar një politikë penale më të ashpër, shprehur nëpërmjet masash më të rënda dënimi.

Së dyti, përfshirjen e trafikimit të brendshëm, jo vetëm për personat e rritur, po edhe për të miturit.

Pra, në legjislacionin aktual, në lidhje me trafikimin e brendshëm, ne mendojmë të jetë i veçantë trafikimi i brendshëm për të miturit. Pra, trafikimi i brendshëm për të miturit, nëse është paragraf, ku mund të jetë si dispozitë rënduese, të bëhet e veçantë.

Së treti, është shtuar termi që nuk merret parasysh pëlqimi i viktimës për shfrytëzimin e synuar apo të realizuar, neni 52/a. Në fakt, shpeshherë viktimat ndjehen të frikësuara, janë nën presion psikologjikë, tërhiqen nga dëshira apo vullneti për të treguar, për të kallëzuar, dhe shpeshherë ndryshojnë edhe deklaratimet e tyre.

Në lidhje me këtë, zonja kryetare e komisionit, ju informoj se me iniciativën e zyrës së koordinatorit, ne kemi ngritur një grup *ad hoc* për kryerjen e një analize dhe vlerësimi, të cilën në fakt do ta sugjeroja si të dobishme t'ia përcillja edhe komisionit. Ju kërkoj ndjesë, që sot nuk e kam, por do t'jua përcjell me e-mail. Analizën e kemi përfunduar. Pra, një vlerësim i thelluar mbi nevojën për një ligj të veçantë, me fokus mbrojtjen e viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit. Gjithmonë në progres-raport dhe në raportet e GRETA-s, pra të grupit të ekspertëve të lartë kundër trafikimit të personave, në Këshillin e Europës, është dhënë gjithmonë si rekomandim, që Shqipëria duhet të ketë një ligj të veçantë për mbrojtjen, sepse pjesa më e madhe e vendeve të Europës, e ka. Nëpërmjet këtij grupi *ad hoc*, ne kemi bërë një analizë, të cilën do të doja t'ia vija në dispozicion komisionit tuaj.

E dyta, me vendimin e Këshillit të Ministrave, është bërë miratimi i procedurave të reja standarde të veprimit, në lidhje me mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

E treta, janë në proces nënshkrimi formatet e unifikuara mbi identifikimin e viktimave të trafikimit, në zbatim të protokolleve shtesë, që e ceka pak, pra bashkëpunimi rajonal me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut. Draftet, formatet i kemi gati, i kemi negociuar me homologët tanë, ndërsa tani thjesht presim nënshkrimin.

Në drejtim të shtyllës së dytë, që është shtylla e mbrojtjes së viktimave, masat e realizuara janë këto:

Mbrojtja dhe asistenca për viktimat ofrohet, siç e thatë edhe ju, përveç se në qendrën kombëtare, edhe në strehëzat e ngritura për viktimat e trafikimit, ashtu edhe në komunitet.

Në fakt, të katër strehëzat që kemi, ofrojnë shërbime integrale. Asistenca psikologjike, shëndetësore, ligjore, formim profesional, ndërmjetësimi, bashkimi me familjet, punësimi dhe edukim për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme, të huaj apo vendës, të mitur a të rritur, meshkuj ose femra, është shtuar. Ata kanë mbështetje jo vetëm nga buxheti i shtetit, për të dalë edhe të mbështetja në buxhet, jo vetëm pjesa që marrim gjithmonë, por që nuk e marrim nga Ministria e Brendshme, sepse është Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale që e jep këtë buxhet, por edhe nëpërmjet projekteve të ndryshme.

Kushtet janë vlerësuar. Edhe në një vizitë të fundit të ekspertëve të GRETA-s, që patëm me zyrën e koordinatorit, pasi vizituar qendrën kombëtare dhe disa nga strehëzat, në draft-konkluzionet paraprake, në një takim të fundit që patëm me ne, pavarësisht se raporti do të dorëzohet në mars të 2020-ës, ata shprehën përshtypjen e mirë për kushtet në të cilat asistoheshin viktimat e trafikimit. Unë mendoj se kjo është një gjë shumë pozitive.

Po ashtu, në drejtim të përmbushjes së planit të veprimit, ka vazhduar e do të vazhdojë mbështetja financiare si ndaj viktimave të trafikimit, për rimëkëmbjen e tyre, ashtu edhe ndaj organizatave shtetërore joshetërore, të cilat me eksperiencën e tyre bëjnë të mundur një jetë më të mirë për këtë kategori vulnerabël. Kjo, zonja kryetare, përveç fondit që marrim nga ministria, kjo bëhet e mundur nëpërmjet projekteve të ndryshme, të cilat mbështesin këto strehëzat, për të ofruar asistencë.

Në fakt, strehëzat kanë thithur goxha projekte dhe ndihma nga donatorët, të cilët, të themi të drejtën, kanë qenë aktivë në ndihmën që u kanë dhënë strehëzave, për të asistuar viktimat e trafikimit. Për këtë qëllim, ne bëmë edhe mbledhjen e koordinimit të asistencës së të gjithë donatorëve, për të mbledhur impute dhe për të parë ku janë nevojat dhe ku kemi boshllëqe. Pra, kjo mbledhje u bë pikërisht në funksion të këtij aktiviteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, në vlerë të donacioneve.

(Ndërpreje e shkurtër incizimi)

Ermonela Felaj – ...është koordinatore në drejtori, kështu që patjetër, zonja Qyra.

Mimoza Qyra – Faleminderit!

Në fakt, me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik bashkëpunojnë disa organizma ndërkombëtarë, por edhe ambasada. Një ndër to, siç e tha edhe zëvendësministrja,

është Ambasada amerikane, e cila nëpërmjet një projekti që e ofron çdo dy vjet pranë institucioneve që operojnë në fushën e luftës kundër trafikimit të personave, ka ofruar një projekt prej 700 mijë dollarësh, që zbatohet nga organizata *Terre des hommes*, dhe mbaron në korrik të vitit 2021.

Po kështu, edhe Ambasada angleze ka një projekt të madh prej 2 milionë paundësh, të cilën do ta ofrojë qoftë në asistencën për mekanizmat e referimit të institucionit, por edhe direkt për viktimat, apo organizatat, shelter-ët që ofrojnë shërbime direkte për viktimat.

Ermonela Felaj – Besoj se ato projekte i përzgjedhin vetë, patjetër.

Mimoza Qyra – Jo, është mundësuar nëpërmjet një aplikimi pranë Ambasadës angleze. Është e hapur.

Ermonela Felaj – E përzgjedhin vetë. Nuk ka lidhje Ministria e Brendshme, që përzgjedh projektet. Ata i menaxhojnë dhe i administrojnë vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe këtë fjali.

Rovena Voda – Po, edhe këtë fjali dhe e mbylla.

Ermonela Felaj – Përgjigjen për zotin Zeneli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rovena Voda – Kam akoma plot për të thënë, se jam trajnuar nga kryetarja juaj. Kam pasur kënaqësinë të punoj me zonjën Felaj, dhe ka qenë një eksperiencë e jashtëzakonshme për mua.

Më lejoni të them se, për sa i përket projekteve, kjo me 2 milionë paund është një asistencë që vjen në kuadër të bashkimit të Shqipërisë me një pjesë të mirë të vendeve të zhvilluara të BE-së, e jo vetëm vendeve anëtare të BE-së, kundër skllavërisë moderne. Është një asistencë që mu premtua vjet, kur bëra vizitën, por u treguan shumë korrektë. Në fakt, ata e kanë lëvruar fondin prej 2 milionë paundësh. Pra, fondi është në dispozicion. Thirrja është e hapur. Bëhet nga ambasada, më lejoni ta sqaroj. Sigurisht, ata kanë vënë kriteret e tyre, dhe do të jetë një konsorcium. Pra, nuk do t'i lihet në dorë vetëm një organizatë, që të menaxhojë fondin, por do të jenë disa organizata. Në fund të fundit, për implementimin e projekteve do të mbështeten nga ne, kështu që na kanë thënë se sigurisht, një mendim në lidhje me përzgjedhjen do ta japim edhe ne.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Zeneli, se këtu e kishit pyetjen, në fakt.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Për mendimin tim, ju bëtë një përshkrim të mirë të gjithë punës tuaj. Një ndër punët më të rëndësishme që bën Policia e Shtetit, është edhe lufta kundër trafikëve. Normalisht, kjo bëhet në trajtimi të vazhdueshëm të të gjitha strukturave të Policisë së Shtetit.

Unë kisha një pyetje në lidhje me pjesën tjetër, që besoj se është shumë e rëndësishme, se në çfarë raporti bëhet fushatë sensibilizuese, që sipas mendimit tim është edhe një pjesë shumë e rëndësishme e luftës kundër këtij fenomeni shumë të rrezikshëm për shoqërinë shqiptare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Zeneli!

Po, zonja Voda.

Rovena Voda – Faleminderit për pyetjen!

Alban Zeneli – Më falni, mund të shtoj diçka?

Ermonela Felaj – Po, urdhëroni.

Alban Zeneli – Pyetjen e pata për pjesën tuaj si institucion i Ministrisë së Brendshme, jo për pjesën e organizatave joqeveritare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Mund të vijoni.

Rovena Voda – Është e vërtetë se, kur flitet për trafikimin, sigurisht, unë e shpjegova pak që Zyra e Koordinatorit është koordinuese, por nuk jemi të vetmit, në kuptimin që nuk e bëjmë vetëm të gjithë punën tonë.

Madje, pas këtij parashtrimi që bëj unë dhe mbrapa figurës sime (si person që vij raportoje sot), sigurisht që ka një armatë të madhe institucionesh, njerëzish, profesionistësh, të cilët na kanë ndihmuar për këtë punë të mirë dhe për risitë, do të thosha unë, që është bërë në këta dy vjetët e fundit. Kështu që edhe për sa i përket ndërgjegjësimit, zyra koordinon. Meqenëse më pyetët kryesisht për Ministrinë e Brendshme, (po e marr si ministri, duke e lënë mënjanë pjesën e mekanizmit kombëtar të referimit, ku i kemi të gjitha institucionet), në ministrinë tonë kemi Drejtorinë e Koordinimit me Prefekturat. Në fakt, tashmë jemi edhe ministria përgjegjëse për pushtetin vendor. Më lejoni të them se Shqipëria përbën një model të mirë për sa i përket luftës kundër këtij fenomeni në nivel vendor dhe këtë do ta lidh me ndërgjegjësimin. Ne kemi një model shumë të mirë që janë komitetet rajonale kundër trafikimit të personave, të cilët udhëhiqen nga prefektët e qarqeve.

Rovena Voda – Është e vërtetë, edhe me zotin Vorpsi kemi bashkëpunuar shumë ngushtë kur ka pasur detyrën e prefektit.

Më lejoni të them se pjesën e ndërgjegjësimit ne jemi munduar ta koordinojmë dhe t'i rakordojmë të gjitha aktivitetet dhe planet. Me thënë të drejtën, prefektët kanë qenë shumë të rregullt edhe në ndarjen e planeve, duke bërë transparencë me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar të Ndërgjegjësimit. Pra, këto komitete rajonale kanë punën e tyre në territor. Pra, pavarësisht se ne jemi lart, në qendër, dhe shohim këto politikat e mëdha, bëjmë monitorimin e të tjera, të mos harrojmë se fushatat e ndërgjegjësimit, përveç muajit tetor, që është shpallur muaji i luftës, i sensibilizimit kundër këtij fenomeni (ku edhe Zyra e Koordinatorit është shumë e përfshirë, madje të gjitha institucionet), në 11 muajt e tjerë të vitit janë komitetet rajonale të antitrafikut me prefektët, të cilët punojnë ngushtë në komitetet e tyre për t'i bërë. Madje, për të qenë e sinqertë, ndërgjegjësimin e bëjnë kryesisht me drejtoritë rajonale arsimore. Pra, punohet ngushtë me DAR-et, tashmë edhe me zyrat arsimore, për të pasur plane më të detajuara me vetë drejtoritë rajonale.

Në fakt, më vjen mirë që, pavarësisht problematikave që shpeshherë ngrihen, po rrisim një brez shumë të mirë. Kam qenë prezente në shumë ekspozita, ku ka një ndjeshmëri shumë të lartë të target-grupit të adoleshentëve ndaj këtij fenomeni. Ata kanë paraqitur realisht vepra apo punime shumë të mira që tregojnë se kanë disa njohuri, janë të ndërgjegjësuar, por, sigurisht, duhet bërë ende punë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Natyrisht, e vlerësoj maksimalisht punën tuaj, zonja Zëvendësministre, si drejtuese e Zyrës së Koordinimit të Antitrafikeve, por trafikimi i qenieve njerëzore është një çështje shumë sensitive dhe kërkon angazhim dhe koordinim ndërmjet disa institucioneve. Ju, në fakt, e shpjeguat se niveli më i lartë i koordinimit janë komitetet e antitrafikut në rang qarqesh, pra ndërmjet 12 qarqeve, por ju, si koordinator e Përgjithshme, a keni ndonjë model produkti? Sepse produkti, natyrisht, ka një model, në kuptimin që 12 qarqet duhet ta kenë një model. Kjo është pyetja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Model suksesi.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Ndërkohë, mund ta lejoj zotin Duzha të bëjë pyetjen e tij, për të vijuar me marrjen e të gjitha përgjigjeve bashkë.

Po, zoti Duzha.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Zëvendësministre! Ju dëgjova me vëmendje dhe më vjen mirë që numri i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është në rënie. Kjo falë punës suaj dhe ndërgjegjësimit që u është bërë atyre, por mendoj se një shkak tjetër i rënies së këtij numri është se trafikantët, të cilët janë marrë me trafikimin e qenieve njerëzore, kanë kaluar tek trafikimi i lëndëve narkotike dhe më lind pyetja: a keni raste të trafikimit të këtyre femrave ose të këtyre meshkujve për këtë qëllim, pra për përdorimin e tyre për trafikim të lëndëve narkotike?

Së dyti, si ka qenë bashkëpunimi i viktimave të trafikimit me institucionet ligjzbatuese? A i kanë treguar tutorët e tyre? Nëse po, a janë dënuar dhe sa të tillë keni të dënuar?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Duzha!

Nëse mundem, dua t'i shtoj diçka të vogël pyetjes së zotit Duzha, por pak më ndryshe: në rastet e evidentimit të trafikantëve të qenieve njerëzore, a ka ndërmjet tyre që, përveç trafikimit të qenieve njerëzore, kryejnë edhe trafikun e drogës? A keni arritur ta merrni këtë të dhënë nga brenda, se, normalisht, emrat janë të skeduar e të gjitha me radhë, pra të dhënat njihen, por këtë lloj evidentimi e keni bërë për të parë që kryhen të dyja krimet, njëherazi ose në kohë të ndryshme, kjo nuk ka rëndësi, por që i ushtrojnë të dyja?

Rovena Voda – Po e filloj me përgjigjen e pyetjes së zotit Vorpsi. Është e vërtetë që ne kemi 12 KRAT-e, pra Komitete Rajonale të Antitrafikut, por, të jem e sinqertë, e kam të vështirë të ndaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E vërtetë, ashtu është!

E kam të vështirë, në fakt, ta ndaj punën, sepse, të jem e sinqertë, përkushtimi i të 12 prefektëve nuk ka munguar. Pra, të 12 prefektët janë munduar që të bëjnë një punë shumë të mirë, megjithëse kanë qenë të ngarkuar. Të mos harrojmë që prefektët, siç edhe ju e dini, janë tashmë edhe kryetarë të task-forcave vendore për planet e veprimt kundër kanabisit, janë edhe kryetarë të komiteteve rajonale të turizmit, besoj se janë pjesë edhe e komiteteve të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, koordinojnë, por, gjithsesi, është një lloj përgjegjësie, pasi, në fund të fundit, raportimi vjen prej tyre. Megjithatë, nuk është se e kanë lënë pas dore edhe pjesën e trafikimit të qenieve njerëzore. Janë munduar të jenë aktivë.

Tani, unë do ta them një shembull shumë të mirë koordinimi, por kjo jo se unë jam nga Durrësi: ka qenë Komiteti Rajonal Antitrafik i Durrësit qysh me ish-prefektin, që sot është deputet, zotin Xhelili...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ka qenë shumë aktiv, por mos ma merrni kështu nga ana krahinore!

Megjithatë, edhe prefekti i ri i Durrësit, zoti Nasto, është goxha aktiv. Kjo për faktin se e lidh pak me atë që tha zoti Vorpsi, problematikat janë më të ndjeshme në zonat kufitare, prandaj nuk duhet të harrojmë se Durrësi ka edhe portin më të madh.

Pra, Durrësi dhe Vlora mbeten zona të nxehta ose *hot spot*-e në këtë veprimtari, pse jo edhe Kukësi tashmë, sepse kemi raste të kalimit nëpërmjet Morinës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, nëpërmjet Morinës. Po shohim një angazhim të shtuar nga prefekti i Kukësit, i cili ka qenë pothuajse ndër të parët që më ka depozituar planin, edhe atë mujor, për të gjitha aktivitetet, për muajin antitrafik (për tetorin)...

Këto janë qarqet që janë disi me rrezikshmëri më të lartë, por që kanë edhe performancën, ndoshta do të thosha, më të mirë. Pra, angazhimi i prefektëve nuk ka munguar.

Ndërsa, nëse do të kaloj te përgjigjja e pyetjes suaj, për sa u përket rasteve të veprave penale, si trafikimi i drogës dhe trafikimi i qenieve njerëzore, nga statistikat që ne kemi për këtë vit, por qoftë edhe për vitin 2018, rastet e evidentuara të trafikimit, të cilat tashmë janë në prokurori dhe për disa prej të cilave, shumë pak, por janë edhe dhënë edhe vendime nga gjykatat, janë pesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kemi pesë vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, më lejoni ta jap këtë të dhënë, për nëntëmujorin e parë të vitit 2019. Këto janë raste të pastra, pra janë vetëm raste që janë hetuar dhe janë gjykuar për trafikimin e qenieve njerëzore, jo të lidhura me...

Por është me vend edhe ajo që tha kryetarja lidhur me momentin kur është identifikuar vepra penale, pra nuk lidhen direkt me trafikimin e drogës... Por është e vërtetë se autorët e këtyre veprave penale kanë një të kaluar. Kur është bërë dikur një lloj vlerësimi

nga ne për grupet kriminale në vitin 2017, është parë që kryesisht ata persona, të cilët janë marrë ose merren me trafikimin e qenieve njerëzore, kanë pasur një të kaluar edhe me trafikimin e lëndëve narkotike apo në raste të caktuara merren me të dyja llojet e trafikeve.

Mjafton të them që vitin e kaluar, kur u bë arrestimi i disa prej anëtarëve të grupit “Bajri”, i cili mbahej si një nga grupet e strukturuar kriminale të rrezikshme, autorët ose anëtarët e këtij grupi kriminal nuk akuzoheshin vetëm për trafikimin e lëndëve narkotike, por, po të shikoni akuzat, ato rëndonin edhe për shfrytëzim prostitucioni, pra për trafikimin e qenieve njerëzore.

Domethënë, ka raste kur ndërlidhen, por të paktën nga statistikat e vitit 2019 nuk e kemi këtë të dhënë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ia kaloj fjalën zonjës Gjebrea për një konstatim të fundit, edhe në formë sugjerimi, se çfarë mund të bëjmë më mirë së bashku.

Elona Hoxha – Faleminderit, zonja kryetare!

Në radhë të parë, më vjen mirë, edhe si ish-koordinatore kombëtare, që Komisioni për Sigurinë Kombëtare sjell në vëmendje çështjen e trafikimit të personave. Pse jo, le të bëhet një traditë e mirë që ne të kemi mundësi gjithnjë, ndoshta një herë në vit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe më shpesh, por po them një herë në vit, që të kemi një raportim të Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit të Personave. Në fakt, kjo është një traditë që njihet dhe zbatohet edhe në shumë vende të tjera. Kam qenë personalisht në një vizitë zyrtare në Izrael, ku koordinatorja kombëtare do të raportonte pranë komisionit dhe, në fakt, periudhën e zgjidhnin gjithmonë pas publikimit të raportit të TIP-it të DASH-it. Por çdo vend mund të vendosë procedurat e tij.

Së dyti, dëshiroj ta falënderoj, në fakt, zonjën zëvendësministre dhe të gjithë ekipin e saj për punën e bërë! Duke punuar vetë, unë e di se sa e vështirë është të punohet deri diku me staf të reduktuar, por, nga ana tjetër, të koordinosh në nivel kombëtar të gjitha strukturat, të cilat janë të vendosura në institucione të ndryshme, pra të arrish të kesh një intensitet pune për t’u bërë ballë të gjitha sfidave që ka lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore nuk është e lehtë.

Kështu që, në këtë këndvështrim, meritoni falënderime për të gjithë punën e bërë dhe për të gjithë angazhimin e strukturave për të pasur një mekanizëm funksional.

Ndoshta ngaqë kam punuar, do të dëshiroja të futesha në disa detaje, duke pasur edhe mirëkuptimin tuaj, qoftë edhe me sugjerime, sado nuk është e thënë që sugjerimet e mia të qëndrojnë të gjitha. Unë i kam bërë një lexim të detajuar raportit të fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit, që, për mua, është një guidë shumë e mirë, pasi futet në detaje në katër blloqet kryesore që ka puna për luftën kundër trafikimit të personave, sepse gjithmonë bën një analizë krahasuese, të paktën me vitin paraardhës e kështu me radhë.

Pa dyshim, Shqipëria është në grupin e dytë. Unë e kam thënë gjithmonë edhe në vizitat që kemi pasur, edhe në takime të ndryshme, se Shqipëria e meriton të jetë në grupin e parë, sepse ka bërë goxha punë. Meqenëse përmenda Izraelin, e kam parë edhe se çfarë ofron Izraeli, i cili është në *tier I*, por, gjithsesi, mendoj se ne kemi mundësi që së shpejti ta shikojmë edhe Shqipërinë në kategorinë 1. Nga ana tjetër, është bërë një punë frontale dhe, pa dyshim, meriton falënderime.

Shqetësimi im, në fakt, ka të bëjë, në radhë të parë, me pjesën e koordinimit ndërmjet policisë, prokurorisë dhe gjykatës. Në fakt, ju e thatë që reforma në drejtësi mund ta ketë dhënë impaktin e saj, por, gjithsesi, shikoj që edhe policia e ka ulur numrin e referimeve. Prokuroria merr ato çfarë i jep policia dhe kështu vazhdojnë me radhë. Ndoshta trajnimet e vazhdueshme, sikurse thuhet edhe te rekomandimet (gjithsej tetë rekomandime për vitin 2019), janë me përparësi për Shqipërinë në luftën kundër trafikimit të personave, ndërkohë që edhe pjesa e ndjekjes penale, edhe e gjyqimit të rasteve të trafikimit janë përsëri prioritete që ne duhet t'i ndjekim.

Do t'ju sugjeroja që të kemi gjithnjë një plan veprimi të bazuar edhe te rekomandimet e TIP-it, sepse është mirë ta keni.

Me siguri që e keni, por po them që është mirë të jetë në mënyrë të vazhdueshme, sepse bën edhe një analizë krahasuese për sa u përket prioriteteve. Sigurisht, e kuptoj që është një luftë, e cila nuk zhvillohet brenda territorit të vendit. Pa dyshim, siç e thatë edhe ju, në fakt, edhe protokollet e punës me këto vende, e cila është punë voluminoze, kanë edhe pengesa burokratike që nuk varen nga ne. Ju përmendët rastin e Greqisë e të tjera. Do të dëshiroja që të ketë një vëmendje të shtuar, që ju e keni, por ndoshta duhet një strategji më vizibël për sa i përket punës me Mbretërinë e Bashkuar. Ka një konfuzion dhe, sigurisht, MKR-të tona nuk përputhen. Ne e kemi diskutuar disa herë rastin kur persona, të cilët shkojnë për qëllime të ndryshme, por jo për qëllime trafikimi, referohen si raste të trafikimit.

Mendoj se duhet gjetur një mekanizëm që të mos na referojnë, pasi figurojmë, pa dashje ose në mënyrë të padrejtë si të tillë. Ne kemi një rritje të numrit kumulativ të viktimave të trafikimit jashtë territorit të Shqipërisë, sikurse është rasti i Mbretërisë së Bashkuar.

Pjesa e njësive të lëvizshme përsëri mendoj se ka nevojë për një përshtatje, pasi jo gjithmonë një model që zgjidhet funksionon në mënyrë të vazhdueshme. Pa dyshim që kjo kërkon nga ju ndoshta një plan më agresiv për sa i përket edhe punës së detyruar, që është përsëri një gjë e vështirë dhe shërbimi social ka rolin kryesor dhe duhet ta ketë në lidhje me këtë, ndaj Zyra e Koordinatorit është në këtë rast në rolin e një mekanizmi koordinues.

Faktikisht, unë nuk e mora të qartë informacionin se sa viktima të trafikimit janë te qendra shtetërore. Ky është një shqetësim, në fakt, që e kemi pasur edhe më parë. Pra, është një qendër e plotësuar, por nuk ka shumë viktima të trafikimit, ndoshta edhe për shkak të vetë profilit. Por kam përshtypjen se edhe ne vetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

80 janë gjithsej?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por sa janë qendra shtetërore?

Janë 9? Sa punonjës ka, për shembull, bie fjala? Ka një diskordancë, ndaj duhet gjetur një mekanizëm, sepse kanë shumë *shelters*-a dhe jo shumë qendra kombëtare. Pra, ndoshta duhet parë një mekanizëm ose të bëhet një vlerësim se çfarë mund të adaptohet.

Përsëri dua të sjell në vëmendje të komisionit se Qendra Kombëtare për Viktimat e Trafikimit nuk është në varësi të Ministrisë së Brendshme, por është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Unë besoj se Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik mund të tërheqë vëmendjen apo të sugjerojë një mekanizëm, i cili të jetë nxitës pasi vërtet është një qendër model. Në fakt, unë kam qenë para një viti e gjysmë në këtë qendër si e ftuar nga zëvendësministrja, me rastin e Vitit të Ri, dhe pashë vërtet një qendër model dhe një drejtor, i cili kishte sjellë një frymë tjetër në atë qendër.

Unë dua të them diçka edhe për sa u përket raportimeve. Në fakt, këto janë gjëra teknike dhe ky është thjesht kuriozitet im, por ka qenë një *database*, në të cilën hidheshin të dhënat për viktimat e trafikimit. Prezupozohej që ky *database* të prodhonte disa informacione për sa i përket profilit, por edhe disa detaje të tjera. Mendoj se ka ardhur koha që Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik të ketë një profil të *research*-it, pra të prodhojë më shumë analiza të detajuara në formën e grafikëve e të tjerë, të cilat jo gjithmonë duhet të ndahen me

publikun, në mënyrë që të kuptojmë më shumë situatën. Unë di që është një *database*, i cili ka qenë funksional dhe jam e bindur që është i tillë.

Zonja zëvendësministre, për sa i përket pjesës së ndërgjegjësimit, përsëri do të doja të ketë një fizibilitet më të madh. Ne të gjithë mund të përfshihemi, madje edhe ne deputetët në zonat tona elektorale. E them këtë jo për bërë politikë, por mendoj se duhet të përfshihen të gjitha grupet vulnerabël. Unë jam deputete e një njësie të varfër, dhe, në fakt, kam menduar që brenda muajit tetor të bëj një aktivitet ndërgjegjësues me të rinj, të cilët shumë lehtë mund të bien pre e trafikimit. Ndonjëherë kjo duket shumë e vështirë, sepse, sigurisht, jo çdo person mund të bjerë pre e trafikimit, por ka edhe persona që mund të bien lehtë pre e trafikimit dhe të tilla raste ka pa fund.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik duhet të rrisë fizibilitetin për sa i përket publikut qoftë me emisione televizive apo me informacione të shumta. Sigurisht, kjo është çështje e buxhetit dhe unë e kuptoj që nuk është e lehtë. Pa dyshim duhen inkurajuar institucionet përkatëse, sepse, e theksoj, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik nuk mund t'i bëjë të gjitha gjërat vetë.

Nga ana tjetër, ne kemi pasur një linjë kombëtare për trafikimin me numër telefoni 116 006. Përsëri theksoj se edhe kjo gjë është e vështirë, pasi njerëzit gjithmonë marrin në telefon policinë. Kjo është një punë, e cila kërkon kohë, por mendoj se në duhet të përpiqemi çdo vit, në mënyrë që për një afat të caktuar kohor ky numër telefoni të bëhet vërtet një numër identifikues për viktimat e trafikimit. Besoj se jeni në dijeni të vizitës që ka bërë grupi i punës i ardhur nga SHBA-të në qendër, e cila ofronte asistencën e saj për sa i përket kësaj çështjeje. Madje, unë jam çuditur kur e pyeta grupin e punës se sa kohë u ishte dashur atyre për këtë çështje (sepse isha e shqetësuar që ne nuk kishim shumë raste të rënies së telefonit), dhe ata më thanë se u ishte dashur 10 vjet që të arrinin të ndërtonin një strategji afatgjatë që të siguronte pikërisht një ndihmë më shumë për viktimat e trafikimit. Kështu, përsëri do t'ju inkurajoja që të punoni më shumë për sa i përket ndërgjegjësimit lidhur me këtë numër telefoni, i cili, sigurisht, ka pasur edhe një kosto të caktuar në momentin kur është krijuar.

Për sa u përket *shelters*-ave në mënyrë të vazhdueshme ngrihet një shqetësim lidhur me mbështetjen financiare. Unë e di që edhe kjo është një sfidë e vështirë, por mendoj se mund të gjenden disa mekanizma lidhur me *shelters*-at. Qëllimi i vendosjes së *shelters*-ave në nivel lokal ishte që të ndihmonin në këtë çështje dhe jo të krijonin pengesa.

Në fakt, raporti që lexova tregon se ka pengesa edhe nga OJF-të e tjera, pasi këto grante janë të dedikuara për viktimat e trafikimit. Kështu, jam e bindur se ju do ta ushtroni

pozicionin e zëvendësministres për të ndihmuar dhe për të kuptuar që ky fond është për viktimat e trafikimit dhe ato OJF-të kanë hapësira të tjera, ku mund të aplikojnë. Mendoj se në momentin që këto strehëza rrezikohen, sigurisht, do të krijojnë edhe probleme.

Dua të sjell në vëmendje për deputetët e nderuar të Komisionit të Sigurisë se këto strehëza funksionojnë në Vlorë, në Elbasan dhe në Tiranë, si komponentë të qendrës së Tiranës, ndërkohë që kemi vetëm një qendër kombëtare të Tiranës. Unë mendoj se ky është një mekanizëm i bukur, në qoftë se funksionon. Në momentin që priset blloku i stehëzave, pa dyshim rrezikohet koordinimi dhe për arsye sigurie duhet bërë edhe transferimi i viktimave të trafikuar. Pra, mendoj se duhet bërë një rotacion ndërmjet strehëzave në disa qarqe të vendit. Përsëri kjo gjë kërkon vëmendje edhe unë, si deputete, pa dyshim edhe të gjithë anëtarët e Komisionit të Sigurisë, mund të japim ndihmën tonë në këtë rast, në mënyrë që ky shqetësim të zgjidhet, të cilin, në fakt, e kemi në dorë, për sa kohë që është një mekanizëm që funksionon brenda nivelit lokal.

Lidhur me lypjen e detyruar për fëmijët e pashoqëruar, për fëmijët e rrugës, si dhe fëmijët, që lëvizin ndërmjet kufijve, mbase ka ardhur koha, pa u ngarkuar me shumë plane (sepse unë e di që kemi gjithmonë vërejtje që bëjmë shumë strategji dhe shumë plane), që të bëjmë një plan të vogël, një plan agresiv, vetëm për këtë gjë, i cili të na japë mundësi që ta zgjidhim këtë çështje. Kjo të bëhet për arsye që vitin tjetër të mos na vijë si një rekomandim nga jashtë, sepse këto janë fenomene, të cilat nuk mbyllen me një vit apo me dy vjet punë, por më shumë vite dhe shumë përpjekje nga të gjitha krahët.

E vlerësoj dhe e mirëpres atë që ju thatë për sa i përket bërjes së një ligji kuadër për viktimat e trafikimit. Personalisht, e kam pasur ëndërr në sirtar në atë kohë, por ishte e vështirë. Unë mendoj se ne, si ligjvënës, mund të japim ndihmën tonë në mënyrë që ky ligj kuadër të bëhet. Sigurisht, kjo do të ndihmojë, sepse kuadri ligjor i trafikimit është i shpërndarë dhe është pak konfuz. Unë mendoj se edhe ne mund të kemi një rol në këtë ligj, por, pa dyshim, kjo kërkon edhe një bashkëpunim ndërmjet Komisionit të Sigurisë dhe zyrës së koordinatorit kombëtar antitrafik. Ju nuk duhet të na shikoni ne si njerëz, që merremi vetëm me ligje, sepse, ndërkohë, ne mund të sugjerojmë. Pa dyshim edhe pjesa e monitorimit, sikurse është edhe kjo e sotmja, është një vlerë e shtuar për punën e deputetit.

Unë mendoj se i thashë të gjitha, ndaj ju komplimentoj dhe ju uroj suksese në punën tuaj fisnike, por edhe të vështirë, që është lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, si një luftë që nuk përfshin vetëm ata, të cilët e kanë për detyrë, por na përfshin të gjithëve, edhe

qytetarët e thjeshtë, në mënyrë që të jemi më vigjilentë, në mënyrë që të mos heshtim, por të raportojmë kur shikojmë raste të tilla trafikimi. Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Gjebrea, për gjithë konstruktivitetin, por edhe për sugjerimet personale, por edhe në emër të Komisionit të Sigurisë!

Besoj se ishit e qartë dhe fjala juaj u ndoq me vëmendje si nga kolegët e komisionit, ashtu edhe nga zëvendësministrja dhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme. Unë mendoj se Ministria e Brendshme, posaçërisht Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, i ka të gjitha mundësitë për të pasur një qasje edhe më agresive në këtë drejtim, sepse këtë mundësi ia jep edhe qenia e saj brenda Ministrisë së Brendshme.

Unë mendoj se si fokus të punës duhet të shfrytëzoni edhe disa hapësira të reja, që janë krijuar ndërkohë. Për shembull, Ministria e Arsimit në një marrëveshje të bërë me ju ka vendosur oficerët e sigurisë në shkolla. Është mirë që këta oficerë sigurie të trajnohen për njohjen e veprave të trafikimit, meqenëse thamë se targetgrupi që preket më shumë është ai i fëmijëve në këtë nivel shkollimi. Unë jam edhe për më shumë se kaq, pra jo thjesht këta oficerë sigurie të trajnohen, por, edhe të raportoni për aftësitë e tyre, sepse jeni ende në fillimet e kësaj pune. Unë di se këta oficerë sigurie merren në provë për 3 muajt e parë, por nga një konstatim imi, gjykoj që ka vend se këta punonjës duhen ndryshuar. Ka shumë njerëz që ndoshta mund ta kenë kaluar intervistën e parë dhe mund të jenë dukur të përshtatshëm për detyrën e oficerit të sigurisë në shkollat e mesme, por është tjetër gjë po t'i shikosh sot në vendet e tyre të punës. Kështu që edhe në këtë rast do të doja të ishit më aktivë dhe ta merrnit ju këtë gjë në dorë. Pra, Ministria e Arsimit ka atë pjesë që ka, por siguria është një çështje që lidhet më shumë me përgjegjësitë tuaja të punës sesa me përgjegjësitë e sistemit arsimor, e cila këtë e ka ndihmë të shtuar.

E dyta, do të doja që këtë gjë ta bënit edhe me të ashtuquajturat njësi të mbrojtjes sociale, posaçërisht me njësitë e mbrojtjes së fëmijëve. E di që bashkitë janë autonome, të pavarura dhe është e vështirë t'i imponohesh punës së tyre, por megjithatë mendoj se rritja e presionit do të mund t'i detyrojë. Nuk është aspak një pamje e duhur që në rrugët tona, në kryeqytet, apo edhe në qytete të tjera, shpeshherë ndeshim fëmijë në situatë rruge dhe nuk asnjë alert në raport me këta fëmijë.

Në qoftë se është një sjellje e mirë hapja e këtyre qendrave sociale ku trajtohen këta fëmijë, kjo pjesë mua më duket se nuk është zgjidhur. Nëse numrat e telefonit vendosen që të jenë si ndihmë, siç është 116, për viktimat e trafikimit, ndoshta ka ardhur koha që edhe qytetarët të kenë një numër apo kontakt, pasi jo domosdoshmërisht në gjykimin tim, sot në

vitin 2019 dhe në prag të vitit 2020 çdo gjë duhet të jetë me telefon, por duhet të ketë një zgjidhje edhe më praktike dhe më thjeshtë sesa marrja në telefon dhe bërja e bisedës nëpërmjet telefonit me qëllim që vetë njerëzit këto raste t'i bëjnë konkrete pranë institucioneve në momentin që i shohin dhe këto institucione të ketë reagim. Unë nuk arrij ta kuptoj dot që njësitë e mbrojtjes së fëmijëve janë dhe nuk kanë fare lidhje me fëmijët që janë në rrugë, nuk sheh asnjë prej tyre. Ndryshe ndodh me qytetarët, të cilët kalojnë aty dhe i shohin përditë dhe nuk bëjnë asnjë reagim.

Nuk po gjykoj këtu se shqetësohem nga ana estetike, por nuk është mirë për një vend, i cili ka një rrjet të gjerë aktorësh që veprojnë në këtë të drejtim, një vlerësim të mirë nga institucionet ndërkombëtare për punën që bën, por edhe mbështetje financiare ka, sepse nuk mund të themi që mbështetja financiare është e vogël, atëherë kjo mbështetje financiare duhet të shkojë edhe në këtë pjesë dhe në këtë mënyrë ne parandalojmë që këta fëmijë të jenë viktimat e ardhshme të trafikimit.

Këto, pak a shumë, ishin ato që unë kisha. Meqë është dëgjesa e parë, mendoj se ia arritëm qëllimit në shumëçka.

Do t'u uroja kolegëve, zonjës Voda dhe zonjës Qyra, suksese në punën e tyre dhe besoj se do të ngelemi në kontakt për të gjitha të rejat në vijim!

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Sa u takon kolegëve, ditën e hënë kemi lënë një vizitë në Drejtorinë e Policisë së qarkut Lezhë dhe me këtë mbyllim kalendarin e vizitave në drejtoritë e policive të qarqeve. Ditën e martë më 22 tetor, do të kemi një seancë dëgjimore me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotin Ardi Veliu.

Shpresoj se të gjithë do të jenë të pranishëm.

Stafin e komisionit e kam porositur që raportet që ne kemi për çdo vizitë në drejtoritë e qarqeve t'ju vihen në dispozicion me qëllim që të keni të përditësuar informacionin që ne kemi marrë pranë tyre.

Ditë të mirë!

MBYLLET MBLEDHJA